



Në përputhje me autorizimin e dhënë në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, si dhe nenin 25, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 nëntor 2011 miratoi:

## **Rregullore mbi Statistikat Monetare-Financiare dhe Llogaritë Financiare**

### **Neni 1 Qëllimi**

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për arritjen e objektivave të saj, përpilon dhe publikon Statistikat Monetare – Financiare dhe Statistikat e Llogarive Financiare. Qëllimi i Rregullores mbi Statistikat Monetare – Financiare dhe Llogaritë Financiare (në tekstin e mëtejshëm “Rregullorja”) është raportimi i Statistikave Monetare dhe Financiare dhe Statistikave mbi Llogaritë Financiare konform standardeve statistikore ndërkombëtare. Rrjedhimisht, Rregullorja definon raportuesit, obligimet statistikore të raportuesve, periudhën e raportimit, raportet statistikore, si dhe konfidencialitetin.

### **Neni 2 Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj Rregulloreje:

— “BQK” – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

— “SMF” – Statistikat Monetare dhe Financiare.

— “SLLF” – Statistikat e Llogarive Financiare.

— “Korporatat financiare” përbëhen nga të gjitha institucionet financiare rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar apo aktivitete financiare mbështetëse që janë të lidhura ngushtë me ndërmjetësimin financiar. Korporatat financiare ndahen në korporata depozituese (banka qendrore

dhe korporatat tjera depozituese) dhe në korporata tjera financiare (ndërmjetësit tjerë financiar, kompanitë e sigurimit, fondet pensionale dhe ndihmësit financiar).

— “Korporatat tjera depozituese” përbëhen nga institucionet financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e masës monetare. Korporatat tjera depozituese përbëhen nga bankat komerciale dhe korporata tjera që mbajnë depozita. Në rastin e Kosovës, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale.

— “Kompanitë e sigurimit” përbëhen nga kompanitë ku funksioni kryesor i të cilave është sigurimi jetësor, sigurimi në rast aksidenti, sëmundjeje, në rast zjarri si dhe forma të tjera të sigurimit për njësitë institucionale apo grupet e njësisive.

— “Fondet pensionale” janë themeluar për qëllime të sigurimit të beneficioneve pensionale për grupet specifike (kontribuuesit) të punëtorëve. Fondet pensionale kanë mjetet dhe obligimet e veta ndërsa bëjnë transaksione ekonomike në emër dhe përgjegjësi të veten.

— “Ndërmjetësit tjerë financiar” përbëhen nga të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësimin financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale. Në Kosovë, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare.

— “Ndihmësit financiar” kanë të bëjnë me institucionet financiare që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë në ndërmjetësimin financiar e që mund të jenë këmbimoret, brokerët, agjentët e ndryshëm, etj. Në Kosovë ky nënsektor përbëhet nga këmbimoret, agjencitë për transferimin e parave dhe menaxherët e mjeteve.

— “Rezident” nënkupton subjektet juridike që janë të regjistruara dhe që veprojnë në Kosovë si dhe personat fizikë, vendbanimi i të cilëve gjendet në Kosovë dhe të cilët nuk largohen nga Kosova për periudhë më të gjatë se një vit (përveç diplomatëve, studentëve dhe pacientëve mjekësor). Me fjalë të tjera, sipas definicioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, rezident të një vendi të caktuar janë subjektet fizike dhe juridike qendra e interesit ekonomik e të cilëve qëndron në vendin në fjalë.

— “Jorezident” nënkupton çdo person fizikë apo juridik që funksionon në bazë të veprimtarisë së tij në çdo shtet tjetër përveç Kosovës. Degët apo nëndegët e një kompanie jorezidente që veprojnë në Kosovë, janë rezident të Kosovës. Në përputhshmëri me këtë, çdo degë apo nëndegë e një kompanie kosovare që vepron jashtë Kosovës është jorezident i Kosovës.

### **Neni 3 Raportuesit**

Korporatat financiare në mënyrë periodike raportojnë në BQK raportet e caktuara statistikore. Në pajtim me nenin 25, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, raportues janë të gjitha korporatat financiare, respektivisht korporatat tjera depozituese (bankat komerciale), kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, ndërmjetësit tjerë financiar (institucionet mikrofinanciare), ndihmësit financiar (agjencitë për transferimin e mjeteve, këmbimoret dhe menaxherët e mjeteve).

BQK-ja, në raste të caktuara specifike, mund të kërkojë nga korporatat financiare raporte statistikore shtesë bazuar në mostrën dhe format e përcaktuara paraprakisht. BQK-ja i informon me shkrim, dhe nëse është e nevojshme i kontakton, subjektet që janë të përfshira në mostër për mënyrën në të cilën duhet të bëhet raportimi.

BQK-ja, për qëllime statistikore sektorizon (klasifikon sipas sektorëve) korporatat financiare konform standardeve statistikore ndërkombëtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Qendrore Evropiane, Eurostatit, etj.

#### **Neni 4** **Obligimet statistikore të raportuesve**

Raportuesit janë të obliguar që t'i ofrojnë informatat që i kërkon BQK-ja me qëllim të përpilimit të SMF-ve dhe SLLF-ve në nivel të Kosovës. Informatat e kërkuara statistikore duhet të jenë të gatshme për BQK-në në formatet e dërguara nga BQK-ja. BQK-ja në parim përcakton subjektet individuale si njësi raportuese.

Për të gjithë raportuesit që nuk i përmbushin kërkesat statistikore të parapara me këtë Rregullore, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 5** **Periudha e raportimit**

Raportet statistikore duhet të dërgohen në BQK në baza të rregullta mujore, sipas afateve të paraqitura më poshtë:

<u>Raportuesit</u>	<u>Afati i raportimit</u>
• Bankat komerciale	t+15 (15 ditë pas periudhës referuese)
• Kompanitë e sigurimeve	t+15 (15 ditë pas periudhës referuese)
• Fondet pensionale	t+15 (15 ditë pas periudhës referuese)
• Institucionet mikrofinanciare	t+15 (15 ditë pas periudhës referuese)
• Ndihmësit financiar	t+15 (15 ditë pas periudhës referuese)

Nëse statistikave përfundimtare nuk janë në dispozicion brenda këtyre afateve, të dhënat e përkohshme (preliminare) duhet të dorëzohen në BQK, brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore. Çdo rishikim (revidim) i statistikave nga ana e raportuesve duhet të raportohet përsëri në BQK, në momentin kur identifikohet ai revidim.

## **Neni 6**

### **Raportet statistikore**

Korporatat financiare raportojnë në BQK në baza të rregullta periodike dhe konform afateve siç është specifikuar në nenin 5 të kësaj Rregulloreje. BQK-ja përmes udhëzimeve për raportim definojnë në mënyrë të detajuar raportet statistikore që dorëzohen në BQK. Udhëzimet për raportim përmbajnë formularët e detajuar për raportim dhe instruksionet mbi plotësimin e këtyre formularëve. Raportet statistikore që dorëzohen në BQK janë:

- Bankat komerciale:
  1. *Raporti Statistikor Bankar;*
  2. *Raporti mbi Normat e Kamatës;*
- Kompanitë e sigurimeve:
  3. *Raporti Statistikor mbi Kompanitë e Sigurimeve.*
- Fondet pensionale:
  4. *Raporti Statistikor mbi Fondet Pensionale;*
- Institucionet mikrofinanciare:
  5. *Raporti Statistikor mbi Institucionet Mikrofinanciare;*
  6. *Raportin mbi Normat e Kamatës të Institucioneve Mikrofinanciare;*
- Ndhmësit financiar:
  7. *Raporti Statistikor mbi Ndhmësit Financiar;*

Kërkesat për raportime statistikore bazohen në standardet statistikore ndërkombëtare siç janë: *Manuali i Statistikave Monetare dhe Financiare* (anglisht: *Monetary and Financial Statistics Manual*, Fondi Monetar Ndërkombëtar 2000), *Udhëzuesi mbi Përpilimin e Statistikave Monetare dhe financiare* (anglisht: *Monetary and Financial Statistics Compilation Guide*, Fondi Monetar Ndërkombëtar 2008), *Sistemi i Llogarive Kombëtare 2008* (anglisht: *System of National Accounts 2008*), *Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Regjionale 95* (anglisht: *European System of Regional and National Accounts 95*), si dhe *Manuali mbi Statistikat e Normave të Kamatës* (anglisht: *Manual on MFI Interest Rate Statistics*, Banka Qendrore Evropiane 2003).

Për qëllime të SMF-ve dhe SLLF-ve, korporatat financiare raportojnë në BQK pasqyrat e audituara financiare (vjetore), konform afatit siç specifikohet në legjislacionin në fuqi. Korporatat financiare duhet të raportojnë informata shtesë statistikore, nëse një gjë e tillë kërkohet nga BQK-ja. Kjo, edhe nëse kërkesat specifike për raportim statistikor mund të jenë të ndryshme nga ato ekzistuese.

## **Neni 7**

### **Konfidencialiteti**

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, BQK-ja respekton konfidencialitetin në lidhje me të dhënat individuale që dërgohen nga raportuesit, si dhe i përdorë ato të dhëna vetëm për qëllime statistikore, siç është përcaktuar në këtë Rregullore.

**Neni 8**  
**Kualiteti i informatave të raportuara**

Me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të kualitetit të statistikave të raportuara, BQK-ja bën monitorimin dhe vlerësimin e kualitetit të të dhënave të dërguara në BQK dhe ndërmer të gjitha masat që i konsideron të arsyeshme dhe të nevojshme për t'u siguruar që cilësia e të dhënave të jetë në bazë të standardeve statistikore të përcaktuara.

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Raportimet statistikore për institucionet mikrofinanciare dhe agjencitë për transferimin e mjeteve do të implementohen që nga janari 2012, ndërsa për kompanitë e sigurimeve dhe fondet pensionale nga marsi 2012.

---

Gazmend LUBOTENI

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës